



**Republika e Kosovës**  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



**Kuvendi i Komunës Istog**  
Skupština Opštine Istok  
Municipal Assembly Istog

**Komititeti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee**

9	<b>P r o c e s v e r b a l</b>
<b>Tipi i mbledhjes:</b>	Mbledhje e rregullt e KPF-së
<b>Data e mbajtjes:</b>	21.12.2018, në ora 10:00
<b>Mbledhjen e kryesoi:</b>	Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit
<b>Procesmbajtës:</b>	Vjosa Hysenaj, Zyrتare për punë të Kuvendit të Komunës.
<b>Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së</b>	Haki Podrimaj, Besa Ferati, Zenel Shatri, Eliot Kukiqi, Ardit Idrizaj, Ajshe Metaj.
<b>Mungojnë:</b>	
<b>Pjesëmarrës të tjera:</b>	Nënkyetari Agim Ademaj, Hysni Maxharraj, Hatixhe Arifaj, Edona Bujupi Loxha, Besart Dreshaj, Mujë Osmanaj, Hazbi Bajra, Zekie Sutaj, Jeta Balaj, Hysen Pelaj OSBE,

#### Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhjet e kaluar,
2. Njoftimi me Raportin e punës NP "Ambienti" për vitin 2018 dhe aprovimi i listës së çmimeve për vitin 2019.
3. Njoftimi me Raportit e Përformances për punën e komunave (Istog) për vitin 2017,
4. Njoftimi me Planifikimin paraprak të Planit vjetor të punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2019,
5. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshëm private me pronën e paluajtshme publike për interesit publik,
6. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së KKSB-së për vitin 2019.

#### Diskutimet:

Kryesuesi – z. Qaush Balaj - përshëndet Nënkyetarin z. Agim Ademaj, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, Drejtoret, Zyrtar të Administratës Komunale, përfaqësues të OSBE, KFORI, mirë se keni ardhur ju faleminderit për pjesëmarrje.

Duke pasur parasysh se kuorumi për mbajtjen e mbledhjes së Komitetit për Politikë e Financa është arritur me lejoni që të shpallë të hapura punimet e mbledhjes se Komitetit për Politikë e Financa.

Ne rend dite kemi një gabim teknik pikë e dytë duhet të hiqet.

Pyet nëse ka dikush ndonjë pyetje.

Hedhe në votim rendin e ditës.

**Konstatojmë se rendi i ditës miratohet një zërit, pa vërejtje.**

**Vendimet:**

**Miratohet unanim rendi i ditës nga KPF-së pa vërejtje**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

### **Shqyrtimi i pikës 1.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e parë të rendit të ditës, Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, materialin e keni pasur dhe keni mundur ta analizoni. Pyete nëse dikush ka ndonjë pyetje apo diskutim rreth procesverbalit.

Pasi që nuk partë diskutime

Procesverbali hidhet në miratim:

**Vendimet:**

**Miratohet Procesverbali nga mbledhja e kaluar pa vërejtje,**

**Personat përgjegjës për zbatim:**

**Afati për zbatim:**

### **Shqyrtimi i pikës 2.**

**Diskutimet:**

Kryesuesi - vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës, Njoftimi me Raportin e punës NP "Ambienti" për vitin 2018 dhe aprovimi i listës së çmimeve për vitin 2019.

Enver Rugova - Drejtor për Shërbime Publike, pëershëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin dhe sqarimin e Raportit të punës NP "Ambienti" për vitin 2018 dhe aprovimi i listës së çmive për vitin 2019.

Haki Podrimaj, LDK - pëershëndet të gjithë të pranishmit, raporti është mirë, vetëm një vërejtje të drejtori së në skicë të hy krahasimi tri vitet e fundit që 2016,2017 dhe 2018 në raport, krekës të shtrihet mirëmbajtja në të gjithë territorin e Komunës.

Enver Rugova, Drejtor - e përmenda edhe GIZ-in Gjermanë që deri 1 vit na mbulon me pastrime. Kemi pasur probleme në të kaluarën se edhe që ne donim të dërgonim kontejner neper lagje e fshatra banoret nuk na lejonin, por tani qytetaret kanë filluar të vetdisohen dhe po i kërkojnë vazhdimesht kontejnerët, por sa po kemi mundësi për mbulues mëri ne po i dërgojmë, por është e pa mundur që në gjithë komunën të kemi mbulushmeri sepse nuk po kemi mjete nuk kemi kamionë.

Ajshe Metaj, PDK - me vjen mirë që ka interesim që kjo kompani të ketë mbulushmeri në teritorin e komunës së Istogut, varianti me thasë është i suksesshëm por i ka të metat e veta aty nëse rritet buxheti i kompanisë të bëhet qentë endacak i qkynë ata dhe mbeturinat shpërndahen gjithandje, në Osojanë kontejnerët janë shitur.

Enver Rugova, për pagesën e berdhokut neper fshatra janë të liruara disa familje.

Eliot Kukiqi, AAK – të te hyrat dhe shpenzimet të bëhet një krahasi dhe të na bini. Me 51 mijë euro çka do të bëhet, të investohet diçka jo të shkojnë në paga dhe mëditje. Kur kam pyetur për disa shpenzime me kanë thëne se janë bërë paga dhe mëditje.

Enver Rugova, këta punëtor nuk janë mirë me paga. Për shkak të jo afermimit nuk ka pasur mjete për amortizim tanë prej vitit 2019 do të ndahen mjete për amortizim duhet me i nda ka 10% për kamionë. Edhe pagat duhet me ju ngrit sepse nuk i kanë pagat e mira.

Ajshe Metaj, PDK – prej këtyre mjeteve nuk ka shpresë për blerjen e kamionit.

Zenel Shatri, LDK – është mirë të bëhet krahasimi me vite në këtë raport. Ditëve të festave nuk janë shprazur kontejnerët, ka pasur në lagjen time si dhe në disa fshatra kam dëgjuar se nuk ka pasur pastrim të kontejnerëve. Propozoj që punët të organizohen më mirë, jam kundër ndalesave sepse po i gjabitni qytetaret me këto kushte.

Enver Rugova – sa i përket ditëve të festave që nuk janë pastruar kontnjeret mund të ketë ndonjë prishje.

Zenel Shatri, LDK – po nëse ka pasur prishje ato evidentohen por para festes nuk janë larguar mbeturinat dhe kanë mbetur aty gjatë gjithë festes.

Ardita Idrizaj, AAK – a keni kontejner për mbeturinat e renda si prishjen e shtëpive.

Enver Rugova, kontejner për mbeturina inerte nuk ka por ka deponi ku mund të hudhen ato.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka kalon në pikën tjeter.

#### Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime të tjera, KPF-ja vendosi: që Raportit të punës NP "Ambienti" për vitin 2018 dhe aprovimi i listës së çmimeve për vitin 2019 i kalohet Kuvendit për shqyrtim.

**Personat përgjegjës për zbatim:** Shërbimi për punë të kuvendit

**Afati për zbatim:** Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 3.

#### Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës. Njoftimi me Raportit e PërfORMANCES për punën e komunave (Istog) për vitin 2017.

Nënkyetari i Komunës - prezanton dhe sqaron Njoftimin me Raportit e PërfORMANCES për punën e komunave (Istog) për vitin 2017

Ajshe Metaj, PDK – Komuna e Istogut për shkak të arritjes së lartë ka marr grantë, por ka fusha që janë evidentuara dhe nuk janë mirë, të skema sociale çka me bë që të kemi një skem të mirë, ujërat e zeza,

personat me aftësi të kufizuara.

Nënkyetari i Komunës - skema sociale ka të bëjë me nivelin qëndron nuk kemi të drejt ligjore të ndikojmë këtu.

Edona Bujupi Loxha, Drejtoresh e Administratës – është viti i tret me radhë që ne si komuna jemi ndër komunat me të mira më performanc që marrim grande, të skemat sociale ne nuk mund të ndikojmë asgjë.

Ajshe Metaj, PDK – qka me bë që personat me aftësi të kufizuara të qasën në punë.

Edona Bujupi Loxha – kushtet janë të barabarta për qdo person që aplikon për punë por nuk kemi raste kur aplikojnë në konkurse, por ne si institucion e kemi kuotën e plotësuar sipas ligjit për persona me nevoja të veçanta.

Eliot Kukiqi, AAK – fusha 10 është me nivelin me të ulet cila është ajo fush?

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera kalojmë në pikën tjetër.

#### Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që Njoftimi me Raportit e Përformances për punën e komunave (Istog) për vitin 2017, dhe e njëjtë i kaloitet kuvendit komunal për shqyrtim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

#### Shqyrtimi i pikës 4.

#### Diskutimet:

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e katërt e rendit të ditës. Njoftimi me Planifikimin paraprak të Planit vjetor të punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2019

Nënkyetari i Komunës – Prezanton dhe sqaron Njoftimi me Planifikimin paraprak të Planit vjetor të punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2019.

Zenel Shatri, LDK – madhra dhe sherbime, paisje e sherbime elektronike dhe paisje teknologjike 10 mijë euro, dhe 12 mijë në dy vende paisje teknologjike. Në shendetësi inserator, kjo paisje e nxjerr veten me e ble sepse ajo që është në Pejë është për të mirën e shtepis së shendetit.

Haki Podrimaj, LDK – betonimi i kanalizimit Vrellë – Prigodë të qitet në shkurt e jo të lihet siq është në korrik.

Ajshe Metaj, PDK – trotuari në fshatin Saradran të qitet si projket me heret.

Hazbi Bajraj, Shef i kabinetit të Kryetarit – ne jemi në njëp bashkpunim me LEGO-n të cilet na kan premtuar atë projekt që do ta realizojn trotuarin dhe ndriqimin në Saradran, shumë shpejt janë premtimet që do të realizohet ky projekt.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera.

**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që Njoftimi me Planifikimin paraprak të Planit vjetor të punës së zyrës së Prokurimit për vitin 2019, dhe e njëjtë i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim.

<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 5.</b>	

**Diskutimet:**

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës. Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshëm private me pronën e paluajtshme publike për interesit publik.

Nënkyetari i Komunës - Prezanton dhe sqaron Propozim - Vendimin e Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshëm private me pronën e paluajtshme publike për interesit publik.

Ajshe Metaj, PDK - a pajtohen palet me ato që ne i propozojm.

Faton Bujupi, zyrtar për qështje prorsoro juridike, po kemi raste kur edhe nuk pajtohen palet po në shumicen e rasteve pajtohen.

Kryesuesi - pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, miratohet në zëri.

**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që miratohet në zëri, Propozim - Vendimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshëm private me pronën e paluajtshme publike për interesit publik, dhe i njëjti i kalohet kuvendit komunal për shqyrtim dhe miratim.

<b>Personat përgjegjës për zbatim:</b>	Shërbimi për punë të kuvendit
<b>Afati për zbatim:</b>	Deri në mbledhjen e kuvendit
<b>Shqyrtimi i pikës 6.</b>	

**Diskutimet:**

Kryesuesi - po vazhdojmë më pikën e tretë të rendit të ditës. Shqyrtimi dhe aprovimi i Planit të punës së KKSBB-së për vitin 2019.

Nënkyetari i Komunës - Prezanton dhe sqaron Planin e punës së KKSBB-së për vitin 2019.

Ajshe Metaj, PDK - fusha e të drejtave të njeriut dhuna në familje, a ka kapacitet komuna ti strehoj viktimat e dhunës.

Nënkyetari i Komunës - këtu sa zbatohet ligji, komuna jon sa të ka mundësi i strehon por këto me shumë janë qështje sociale, me kjo raste merrret policia, Gjykata, dhe shërbimi për qështje sociale dhe familjare, por komuna qfar të mundet bënë për ti mbrojtur.

Ajshe Metaj, PDK – pse ligji nuk po zbatohet në munges të zbatimit të ligjit po privohet jeta e tjetrit.

Haki Podrimaj, LDK – Kuvendorit Komunal e ka propozuar këtë këshill temat janë të qëlluara aty do të debatohet të gjitha keto tema.

Kryesuesi – pasi që diskutime tjera nuk ka hedh në miratim, Planin e punës së KKSBB-së për vitin 2019, miratohet një zëri.

**Vendimet:**

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF – vendosi: që Plani i punës së KKSBB-së për vitin 2019, dhe e njëjtë i kalohet kuvendorit komunal për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendorit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendorit

**DISKUTIME**

Ardita Idrizaj, AAK – të ndertohet një aneks me lodra në oborrin e qerdhes së femijëve në vrellë

Ajshe Metaj, PDK – a ka dikund një zyre dhe një kompjuter në komunë ku GGA mund ta shfrytëzojn për të punuar.

Edona Bujupi Loxha – një zyre të veqant nuk ka por e keni zyren dhe kompjuterin të z. Sanije Mavraj zyrtare për barazi gjinore.

Kryesuesi – para mbylljes së mbledhjes konstaton kuorumin prezentë ishin të gjithë anëtarë e Komitetit për Politik e Financa, ju faleminderit për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë për këtë mbledhje.

Shpall të mbyllura punimet për këtë mbledhje.

**Mbledhja përfundoj :** 11:45